



# Score 250 EC

<b>Lënda vepruese:</b>	Difenoconazole
<b>PËRMBAJTJA:</b>	Difenoconazole 25% Lëndë ndihmëse 75%
<b>Numri i regjistrimit:</b>	AL: 113/1-14.11.2008 KS: 090-0740-11-2007/06.03.2007
<b>Formulimi:</b>	Koncentrat i emulsionueshëm

## **FUNGICID SISTEMIK ME VEPRIM TË FORTË E TË ZGJATUR, PARAMBROJTËS, SHËRUES DHE ÇRRËNJOSËS, PËR KONTROLLIN E KROMËS, HIRIT, NDRYSHQEVE ETJ.**

### **PËRDORIMI:**

Në **MOLLË** dhe **DARDHË** për të kontrolluar **Kromat, Ndryshqet dhe Hiret** me dozë 10-15 ml/100 l ujë (0,2-0,3 l/ha). Spërkatjet fillojnë që nga faza e lidhjes së frutave deri një muaj para vjeljes. Bëhen 4-5 trajtime gjithsej çdo 10-14 ditë.

Në **HARDHI** për të kontrolluar **Hirin** me dozë 12-20 ml/100 l ujë (0,12-0,2 l/ha). Spërkatjet fillojnë me shfaqjen e infeksionit. Bëhen 6-8 trajtime gjithsej çdo 14 ditë. **Kalbëzimin e zi** me dozë 12-20 ml/100 l ujë (0,12-0,2 l/ha). Spërkatja e parë bëhet me shfaqjen e lulerive dhe përsëriten çdo 10-14 ditë. **Njolloshjen e kuqe** me dozë 12-20 ml/100 l ujë (0,12-0,2 l/ha). Spërkatja e parë bëhet në fazën e 2-3 gjetheve, e dyta në 5-6 gjethe. Trajtimet përsëriten çdo 7-17 ditë.

Në **PERIMET** për të kontrolluar **Hiret** me dozë 0,3-0,5 l/ha. Spërkatja e parë bëhet me shfaqjen e shenjave të para të infeksionit dhe përsëriten çdo 14 ditë. **Ndryshqet** me dozë 0,5 l/ha. Spërkatja e parë bëhet me shfaqjen e shenjave të para të infeksionit dhe përsëriten çdo 14 ditë. **Alternariozat** me dozë 0,5 l/ha. Spërkatja e parë bëhet me shfaqjen e shenjave të para të infeksionit dhe përsëriten çdo 7-14 ditë. **Antraknozot** me dozë 0,3-0,5 l/ha. Spërkatja e parë bëhet me shfaqjen e shenjave të para të infeksionit dhe përsëriten çdo 7-10 ditë. **Septoriozat** etj. me dozë 0,5 l/ha. Spërkatja e parë bëhet me shfaqjen e shenjave të para të infeksionit dhe përsëriten çdo 7-10 ditë.

**Vërejtje:** Rekomandohet përdorimi në trajtimet parambrojtëse.

**MËNYRA E PËRDORIMIT:** Me spërkatje.

**FITOTOKSICITETI:** Score nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme.

**IPM:** Score 250 EC është i përshtatshëm për tu përdorur në Programet e Luftës së Integruar.

**PËRZIHET** me shumicën e insekticideve, fungicideve dhe rregullatorëve të rritjes.

**SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES:** Mollë e Dardhë 30 ditë, Hardhi 40 ditë, Perime të fam. Kungullore 3 ditë, të fam. Solanore 7 ditë, Kulturat e tjera 14 –21 ditë.

**PERIUDHA E RUAJTJES:** 3 vjet. Preparati ruhet në ambalazhin original, në vende të ajrosura, pa lagështi dhe jo në kontakt me rrezet e diellit. Evitoni ruajtjen në temperatura nën  $-5^{\circ}$  C dhe mbi  $35^{\circ}$  C.

### MASAT PARAMBROJTËSE

-Evitoni kontaktin me sytë dhe lëkurën. –Mbroni rrugët e frymëmarrjes duke përdorur mjetet mbrojtëse. -Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë përdorimit. -Gjatë punës përdorni mjetet mbrojtëse. -Pas pune duart dhe fytyra duhet të lahen dhe rrobat të ndërrohen. -Lani pajisjet mbrojtëse para se ti ripërdorni.

### UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me lëkurën hiqni menjëherë rrobat e ndotura, lani lëkurën me ujë të bollshëm e sapun. Lani rrobat e ndotura para se ti rivishni. -Në rast kontakti të preparatit me sytë i lani ato me ujë të bollshëm për 10-15 minuta dhe kërkoni këshillë mjekësore. -Në rast se merret me organet e frymëmarrjes nxireni të aksidentuarin në vende të ajrosura. –Në rast gëlltitje jepini në mënyrë të përsëritur karbon aktiv dhe ujë të bollshëm. Çojeni të aksidentuarin në spital dhe i tregoni mjekut etiketën e produktit. Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



I dëmshem në rast gëlltitje.



RELATIVISHT JO HELMUES PËR BLETËT  
HELMUES PËR PESHQIT DHE ORGANIZMAT  
UJORE

Mos ndotni ujrat me preparatin ose me  
ambalazhin e tij.

**TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.**

**PRODHUESI:** SYNGENTA Crop Protection AG,  
Basel, Switzerland  
Tel: +41 61 323 11 11 ; Fax:+41 61 323 12 12